

Mbikëqyrja



Monitorimi dhe kontrolli i projekteve

Menaxhimi i projekteve

Monitorimi dhe kontrolli

- Monitorimi dhe kontrolli i projektit janë ana e kundërt e planifikimit dhe zgjedhjes së projektit.
- **Monitorimi** – është mbledhja, regjistrimi dhe raportimi i informacionit që lidhet me çdo aspekt të performancës së projektit.
- **Kontrolli** – përdor të dhëna nga monitorimi për të përafëruar sa më tepër që të jetë e mundshme performancën aktuale me atë të planifikimit.

Monitorimi dhe kontrolli

- Qëllimi i sistemit të monitorimit është që të mbledhë dhe raportoj të dhënat.
- Qëllimin e sistemit të kontrollit është të veprojmë ato të dhëna.
- Metodatat statistikore janë shumë të dobishme për të përcaktuar se cilat janë të konsiderueshme si dhe për të ndihmuar në përcaktimin e shkaqeve të mundëshme.

- Hapat e kontrollit të projektit



Sistemi 'vlera e arritur'

- Nëse janë shpenzuar 50 % e buxhetit (ose e kohës) supozohet që është përfunduar 50 % e projektit ose është arritur 50 % e qëllimit të performancës.
- Projekti bazohet në standarde të cilat mund të mos jenë kontstante gjatë gjithë jetës së projektit, p.sh. Mund të ndryshojnë nga klienti.
- Informacioni që mblidhet duhet të identifikohet, duhet të përcaktohet se cilat të dhëna nga ato në dispozicion duhet të mblidhen.

Instrumentet ose mënyrat e monitorimit

1. Grumbullimi në mënyrë sistematike i raportimeve me shkrim mbi gjendjen e ecurisë së projektit.
2. Mbledhjet , konsultimet shumëpalëshe më takimet jozyrtare.
3. Auditimi i brendshëm ose i jashtëm i projektit.
4. Regjistrimi kontabël i aktivitetit të projektit.

Raportimi




Figura 36 - Shkalla e realizimit në diagramin Gantt

Llojet e raporteve

- Raportet rutinë – janë ato që lëshohen rregullisht.
- Raportet e veçanta – janë të dobishme në dy raste:
 - 1) për marrjen e vendimeve të menaxhimit të projektit dhe duhen të shpërdahen anëtarëve të ekipit
 - 2) jepen kur vendimi merret si një përjashtim dhe është e dëshirueshme që të informohen menaxherët e tjerë.
- Raportet për analizat speciale – përdoren për të shpërndarë rrezultatet e studimeve të veçanta.

Rregullat e vlerës së arritur

- Rregulli i përqindjes 0/100 – sipas këtij rregulli supozohet që vlerësimi për përfundimin e punës bëhet menjëherë sapo ajo të përfundoj.

100 % e buxhetit arrihet kur puna përfundon


Rregull që përdoret për ato punë që kanë kohëzgjatje të shkurtër.

- Rregulli i përqindjes 50/50 – lejon që 50% e vlerës së buxhetit për punën të arrihet kur ajo fillon dhe 50% do të arrihet kur puna të ketë përfunduar.




Monitorimi i kohës së projektit

Baseline Gantt Chart





Legend

- Baseline duration
- Slack
- Actual completed
- Remaining duration



Tracking Gantt Chart Showing Status through Period 6





Grafiku për kontroll të kohës në projekt

- Çfarë është Menaxhimi i vlerës së fituar (EVM)?

- Çfarë është Menaxhimi i vlerës së fituar (EVM)?
- Teknikë e matjes së performancës së projektit që përfshinë kohën dhe koston.
- *Kur paraqitet plani origjinal dhe ndryshimet e aprovuara ju mund të determinoni se si ka shkuar projekti ne raport me qëllimin kryesor.*

Cfare duhet mbajt në mend?

Patjetër

PV

Vlera e planifikuar (buxheti)

CV

Varianca e kostos

AC

Kosto aktuale (cfare eshte paguar)

SV

Varianca e kohes

EV

Vlera e fituar (Cfare eshte bere)

CPI

Indeksi I performances se kostos

SPI

Indeksi I performances se kohes

PV

Vlera e planifikuar

- (ose Buxheti)
- Tregues për zbatimin e kostos së planifikuar në çdo aktivitet eë projektit.

SV

Varianca e kohës

- Diferenca në mes të kohës së planifikuar për përfundimin e një aktiviteti dhe kohën aktuale të përfundimit të aktivitetit

CPI

Indeksi i
përformancës së
kostos

- Nëse CPI është e barabartë me 1 ose 100 % atëherë koha e planifikuar dhe e përfunduar janë të barabarta.
- Nëse CPI është më e vogël se 1 ose më e vogël se 100 % atëherë projekti ka tejkaluar buxhetin e planifikuar.
- Nëse CPI është mëe madhe se 1 ose se 100 % atëherë projekti është nën buxhetine planifikuar.

SPI

Indeksi i performancës
së skedulit

- Nëse SPI është e barabartë me 1 ose 100 % atëherë koha e planifikuar dhe e përfunduar janë të barabarta.
- Nëse SPI është më e vogël se 1 ose më e vogël se 100 % atëherë projekti ka tejkaluar kohën e planifikuar.
- Nëse SPI është më e madhe se 1 ose se 100 % atëherë projekti është nën kohën e planifikuar.

TERM	FORMULA
Earned value	$EV = PV \text{ to date } X \text{ percent complete}$
Cost variance	$CV = EV - AC$
Schedule variance	$SV = EV - PV$
Cost performance index	$CPI = EV/AC$
Schedule performance index	$SPI = EV/PV$

Formulat për llogaritjen e vlerës së fituar

Shembull

- Projekti 'Instalimi i një web serveri'

Buxheti – Vlera e planifikuar të shpenzohet në detyrë **10,000 €**

Koha e përfundimit të detyrës 1 Javë

Konstatojmë që:

Detyra është përfunduar pas 2 javësh me **20,000 €**

15,000 € janë shpenzuar në javën e parë

5,000 € në javën e dytë

- Sa është varianca e kohës dhe kostos si dhe Indeksi i performancës së kohës dhe kostos per detyren?

Rezultati

- 10000 € - PV
- 20000 € - AC per tere aktivitetin
- 15000 € - AC per javen 1

% e fituar në javën 1 = $15000 \text{ €} / 20000 \text{ €} = 75 \%$

EV = PV x % e fituar ne javën 1 = $10000 \text{ €} \times 75 \% = 7500$

CV = EV - AC = $7500 \text{ €} - 15000 \text{ €} = -7500 \text{ €}$

SV = EV - PV = $7500 \text{ €} - 10000 \text{ €} = -2500 \text{ €}$

CPI = EV/AC = $7500 \text{ €} / 15000 \text{ €} = 50 \%$

SPI = EV/PV = $7500 \text{ €} / 10000 \text{ €} = 75 \%$

Slide 22

Y3

Perdorim kete vlere te AC pasi qe kostoja eshte prej 10000 euro eshte tejkeluar ne javen 1
YLLI, 1/31/2013

Indekset

- Indeksat u mundësojnë menaxherit të projektit dhe klientit për të parë progresin nga disa këndvështrime.

Indeksi	Kosto (CPI)	Skeduli (SPI)
> 1.00	Nën kosto	Përpara me skedulin
= 1.00	Sipas koston	Sipas skedulit
< 1.00	Mbi kosto	Mbrapa Sledulit

Disa rregulla të EV

- Vlerat negative në kosto dhe skedul tregojnë që ka probleme në atë fushë/aktivitet
- Projekti po kushton më shumë se sa që është planifikuar dhe po zgjatë më shumë se sa që është parashikuar.
 - CPI and SPI më pak se 100% d.m. th
PROBLEME

Plani

WBS

Plani i burimeve

Skeduli



Buxheti

Monitorimi

Mbledhja

Kalkulimi

Llogaritjet



KONTROLLI I PROJEKTIT

- Kontrolli është elementi i fundit në zbatimin e ciklit planifikim – monitorim – kontroll.
- Informacioni krahasohet me nivelin e dëshiruar ose të planifikuar dhe ndërmerret veprimi nëse performanca aktuale dhe e dëshiruar ndryshojnë mjaftë e që kontrolli dëshiron të pakësojë ndryshimin.
- Kontrolli përqendrohet në tre elemente të projektit :
 - Performancën
 - Kohën
 - Kostoja

Mënyra e kontrollit

- Devijimi i realizimit të projekteve ndodhë për arsye të ndryshme, objektive dhe subjektive:
 1. Ndodhja e dukurive, jashtë mundësisë për t'i komanduar plotësisht, si janë kufizimet dhe rreziqet e paparashikuara.
 2. Ndodhja e ndryshimeve në treg, të diktuar nga faktorë të tjerë jashtë projektit.
 3. Mungesa e harmonisë ose mungesa e konflikteve brenda ekipit.

Qëllimet kryesore të kontrollit

- Dy objektivat kryesore të kontrollit janë:
 - Rregullimi i rezultateve nëpërmjetë ndryshimit të aktiviteteve
 - Mbikqyrja e aseteve të ndërmarrjes
- **Kontrolli i aseteve fizike** – ka të bëjë me mirëmbajtjen e aseteve në mënyrë të rregullt ashtu dhe atë preventive.
- **Kontrolli i burimeve njerëzore** – kërkon kontrollin dhe ruajtjen e rritjes dhe zhvillimit të njerzëve
- **Kontrolli i burimeve financiare** - përfshijnë kontrollin e aseteve aktuale, të buxheteve të projektit si dhe kontrollin e investimeve kapital.

Procesi i kontrollit të projektit


1. Cila është gjendja aktuale e projektit në lidhje me skedulën dhe me koston?
2. Sa do të duhet për të përfunduar projektin?
3. Kur do të përfundoj projekti?
4. A ka probleme të rëndësishme që duhet të zgjidhen tani?
5. Cilat dhe kush janë shkaqet për tejkalimin e koston dhe të skedulit?
6. Çfarë do të arrihet me paratë e shpenzuara?
7. Nëse ka tejkalim të koston, a mund të parashikohet se sa do të jetë tejkalimi për përfundimin e projektit?
8. A mundet që të identifkohen problemet e mundëshme përpara se të jetë shumë vonë për ti korigjuar ato?

Kontrolli mbi ndryshimet

- Lista e ndryshimeve në projekt mund të jetë shumë e gjatë, mirëpo disa nga ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me :
 1. Ndryshime të strukturës së tregut
 2. Shkurtimi i buxhetit ose i burimeve të tjera të planifikuara
 3. Lëvizja e personelit
 4. Pamundësia e personelit për të respektuar angazhimet
 5. Ndryshimi i përparësive të natyrës organizative

Kontrolli mbi ndryshimet

Për çdo projekt , janë pesë pika të ndjeshme ose komponente kryesore :



Drejtimet kryesore ku mund të përqendrohet menaxheri i projektit për kryerjen e ndryshimeve korigjuese të diktuara nga përfundimet e monitorimit mund të artikulohen si më poshtë:

Rishikimi i prgramit të projektit

Rritja e burimeve njerëzore

Pakësimi i proceseve të punës

Angazhimi i specialistëve më të mirë

Kalimi i proceseve jashtë projektit

Puna jashtë orarit

Rishikimi i rrugës kritike

Ulja e fitimit të programuar

Ndryshimi i karakteristikave të produktit final

Kontrolli mbi shqetësimet

Koha e pamjaftueshme
Optimizimi euforik
Ndryshime të shpeshta
Largimi i punonjësve
Mungesa e profesionalizmit
Shpenzime jashtë kontrollit
Ndërhyrje të tepruara të eprorëve
Polarizimi politik
Komunikimi i mangët me vartësit

Tabela 2 - Shqetësimet më të shpeshta në projekt

Literatura ku bazohet ligjerata

- Ing. Gjençi Gjoka.Udhëzues për menaxherin e projektit . Të punosh me projekte. Shtëpia Botuese Dituria, fq. 208-226.

Literatura shtesë:

- Suzana Panariti: Menaxhimi i projektit, Shtëpia botuese “Libri Universitar” Tiranë, 2004. Monitorimi dhe kontrolli i projektit. Fq.337
- The Project Management Process - Craig Brown, 2008.
- <http://www.slideshare.net/craigwbrown>

- **FALEMINDERIT!!**